



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

Nr. 5694 prot.

Tiranë, më 30.05.2018

UDHËZIM

Nr. 10, datë 30.05.2018

“PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 09.01.2018 “MBI
PËRDORIMIN E SISTEMIT DINAMIK PËR BLERJEN E BILETAVE TË
TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR DHE ZHVILLIMIN ME MJETE
ELEKTRONIKE”**

Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40/1, Kreu IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O N:

1. Pika 2, paragrafi i tretë dhe i katërt riformulohen më këtë përmbajtje:

“Autoriteti kontraktor, rast pas rasti zhvillon procedurë konkurruese sipas parashikimeve në Manualin Teknik, pjesë e këtij udhëzimi, sa herë që ka nevojë konkrete për bileta të transportit ajror ndërkombëtar, duke prokuruar në çdo rast sasinë e nevojshme bazuar në destinacionin e përkatës.

Autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që blerjet gjatë gjithë vitit kalendarik për bileta të transportit ajror ndërkombëtar nuk duhet të tejkalojnë fondin e përlogaritur për këtë zë në regjistër”.

2. Shfuqizohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i sistemit dinamik të biletave, pasi të ketë siguruar apo hartuar

kërkesat për objektin e prokurimit, përlogarit fondin limit për sasinë e biletave që do të prokurojë. në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukturë të posaçme”.

3. Pika 5, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohet sasia e biletave të kërkuara dhe destinacioni përkatës, sipas formularit Nr. 2. bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret”.

4. Në pikën 6, gërma “b” riformulohet me këtë përmbajtje:

“b) Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat sasiore e teknike të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, grafikun e egzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentat që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, nëse është rasti.

Në Ftesën për Ofertë nuk duhet të përcaktohet fondi limit, pasi operatorët ekonomikë duhet të ofertojnë realisht bazuar në të dhënat teknike sasiore që përcaktohen në të”.

5. Pika 12 “Refuzimi i Ofertave”, riformulohet si më poshtë vijon:

“12. Refuzimi i Ofertave:

a) Anëtarët e komisionit të sistemit dinamik të biletave pas hapjes së ofertave në orën dhe datën e caktuar, sipas shpjegimeve të dhëna në manualin teknik, fillimisht do të verifikojnë fushën e veprimtarisë së të gjithë ofertuesve pjesëmarrës në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Nëse pas verifikimeve rezulton se, ndonjë nga operatorët ekonomik nuk ka si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, oferta e tyre do të refuzohet **automatikisht** nga komisioni dhe **nuk do të përfshihet në klasifikimin e ofertave.**

Procesi i refuzimit të ofertave, **për shkak të mospasjes në objektin e ushtrimit të veprimtarisë objektin e prokurimit**, do të reflektohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

b) Anëtarët e komisionit do të refuzojnë **automatikisht** ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme të zhvilluar nga ky autoritet, nuk është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë për të realizuar objektin e prokurimit, **pavarësisht faktit se mund të ketë njoftuar autoritetin kontraktor, por nuk ka dhënë arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.** Ofertat e refuzuara nuk do të përfshihen në klasifikimin e ofertave.

Procesi i refuzimit të ofertave për shkak të mosparaqitjes në një procedurë të mëparshme do të reflektohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

c) Anëtarët e komisionit do të refuzojnë **automatikisht** ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik në rastet kur ka të dokumentuara eksperiencave të mëparshme të përfshirura me sukses me këtë operator ekonomik. Ofertat e refuzuara **nuk do të përfshihen në klasifikimin e ofertave.**

Procesi i refuzimit të ofertave për shkak të eksperiencave të mëparshme të përfshirura me sukses do të reflektohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

6. Formularët nr. 2, 3 dhe nr. 4, si dhe Pika 2 “Krijimi i dosjes së tenderit për prokurimin nëpërmjet Sistemit Dinamik të Biletave” në Manualit teknik ndryshojnë sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Ky udhëzim publikohet në faqen e APP dhe hyn në fuqi në datë 04.06.2018.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Reida Kashta



Konc: D. Elezi

Pranoi: G. Pagria

Two handwritten signatures in blue ink. The first signature is above the name "Konc: D. Elezi" and the second is above "Pranoi: G. Pagria".

URDHËR PROKURIMI

Nr _____ datë _____

**PËR
SISTEMIN DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR**

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar për nevojat e _____ (Autoriteti Kontraktor), të përdoret sistemi dinamik i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me destinacion _____, për sa më poshtë:

1. _____
(Bileta) (sasia dhe njësia)

Etj.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ
TIJ**

(emri, mbiemri, firma, vula)

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja e Internetit _____

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: _____.

Data e zhvillimit do të jetë _____, ora _____ në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentet si më poshtë:

a) rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar;

b) dokumentat të tjera (në rastet kur kërkohen)

Afati i dorëzimit të dokumentave _____.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR/OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ
TIJ**

(emri, mbiemri, firma, vula)

FORMULAR PËR NJOFTIMIN E ANULIMIT TË

SISTEMIT DINAMIK TË BLERJES SË BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja në Internet _____

2. Numri i Referencës: _____

3. Objekti i prokurimit _____

4. Arsytet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1:

a) ☐;

b) ☐;

c) ☐;

ç) ☐;

d) ☐;

dh) ☐;

Etj. _____

5. Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi ☐☐/☐☐/☐☐☐

Kerkesat		Faza				Ndihma	Profil i...	Ditë
Nepunësi / Autorizuar		Faza	Lidhur me	Lloji / Procedura	Krijuar në	Status	Vazhdo	
Detaljat	Detalja të mbështetura (59)	Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar	Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2019	Purchase_Tickets	26.12.2017 22:45	U hap		
	Detalja të mbështetura	Dorëzimi i Ofertës	Dorëzimi i Ofertës biletë avioni për periudhën Janar-Dhjetor 2019	Purchase_Tickets	26.12.2017 15:01	U hap		
Procedura	Procedura Draft	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 11:57	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 10:15	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
	Procedura të Publikuara	Kriteret e Pjestimit	Kriteret e Pjestimit biletë avioni	Purchase_Tickets	26.12.2017 09:01	U hap		
Kerkesat (10)	Kerkesat (10)	Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar	Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar	Purchase_Tickets	26.12.2017 11:50	U hap		

Në dritaren “Kohëzgjatje dhe Vlera e parashikuar” që shfaqet, duhet të plotësoni në fushën “Vlera e përafërt (LEK)” vlerën **0,0** dhe fushën “Kohëzgjatja e kontratës”

Kohëzgjatje dhe vlera e parashikuar

Objekti i Procedurës

Tipi i Kontratës

Vlera e përafërt (LEK)

Vlefshmëria

Vlera e vërtetë

Kohëzgjatja e kontratës

Kohëzgjatja në

Periudha në muaj

Filimi

Procedura

Tipi i Kontratës

Vlera e përafërt (LEK)

Vlefshmëria

Vlera e vërtetë

Kohëzgjatja e kontratës

Kohëzgjatja në

Periudha në muaj

Filimi

Pasi të keni plotësuar informacionin klikoni butonin “**Ruaj**” dhe “**Tjetër**”.

Në dritaren që shfaqet duhet të klikoni butonin “**Shko te Zyrtarët e Prokurimit**”, nëse jeni të sigurt që të gjitha veprimet e kryera nga ana juaj janë të sakta.

Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar

Objekti i Procedurës

Tipi i Kontratës

Vlera e përafërt (LEK)

Vlefshmëria

Vlera e vërtetë

Kohëzgjatja e kontratës

Kohëzgjatja në

Periudha në muaj

Filimi

Procedura

Tipi i Kontratës

Vlera e përafërt (LEK)

Vlefshmëria

Vlera e vërtetë

Kohëzgjatja e kontratës

Kohëzgjatja në

Periudha në muaj

Filimi